




RAPORT VJETOR - 2019



HANDIKOS, 2020

Përmbajtja

PARATHËNIE	2
Përmbledhje Ekzekutive	3
HYRJE	4
Projektet që HANDIKOS ka implementuar gjatë 2019-ës.....	7
SHËRBIMET E OFRUARA PËRGJATË 2019-ës.....	10
➤ Shërbimet ditore për fëmijë.....	10
➤ Shërbimet ditore për të rritur	11
➤ Shërbimet e pajisjeve ndihmëse	12
➤ Shërbimet juridike	13
➤ Shërbime të tjera.....	14
INTERVENIME AVOKUESE DHE LOBUESE	15

PARATHËNIE

HANDIKOS fillimisht është krijuar si reagim ndaj gjendjes së vështirë në të cilën gjenden personat me aftësi të kufizuara në Kosovë. Studimet tregojnë se në shoqëritë e zhvilluara, ofrimi i përkujdesjes shoqërore konsiderohet si një aspekt i rëndësishëm i rolit të shtetit, prandaj përfitimet nga përkujdesja janë pjesë e të drejtave të individit. Qasje kjo që anasjelltas ofron suksesin ose dështimin e përkujdesjes ndaj personave me aftësi të kufizuara, e që për shumë arsye është vendimtare për mirëqenien e shoqërisë.

Sipas Strategjisë Kombëtare për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, gjendja e tanishme e personave me aftësi të kufizuara nuk përmbushë realizimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore në kushte të barabarta me të tjerët. Andaj, si rrjedhojë, të gjitha subjektet janë përgjegjëse për garantimin e kësaj të drejte e cila arrihet vetëm duke eliminuar çdo lloj pengese dhe barriere që krijon vështirësi në respektimin e parimit të mos-diskriminimit ndaj personave me aftësi të kufizuara. Në këtë kontekst, e theksojmë se institucionet e Kosovës kanë akoma shumë punë dhe përpjekje për të bërë.

Si Shoqatë e Paraplegjikëve dhe Paralizës së Fëmijëve të Kosovës, HANDIKOS edhe gjatë vitit 2019 ka punuar në ngritjen e mirëqenies së personave me aftësi të kufizuara, duke lobuar dhe avokuar për një shoqëri gjithëpërfshirëse dhe me kushte të barabarta për të gjithë.

Synimet tona kryesore gjatë 2019-ës kanë qenë të fokusuar në tri objektiva:

- Avokimi dhe lobimi drejt mbrojtjes dhe avancimit të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në përfshirjen e tyre në legjislacionin e Kosovës;
- Vazhdimësia në ofrimin e shërbimeve për fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuara, të cilat janë primare dhe më se të nevojshme të cilat mbesin ende sfidë;
- Ngritja e kapaciteteve të personave me aftësi të kufizuara mbi të drejtat e tyre dhe personelit të HANDIKOS-it;

Personat me aftësi të kufizuara përballen me shumë sfida e barriera në vendin tonë, ndër të cilat ende mbesin: qasja, edukimi, punësimi si dhe respektimi dhe avancimi i të drejtave të tyre, duke u bazuar në legjislacionin e Kosovës dhe dokumentet tjera ndërkombëtare. Kur përmendim sfidat, gjithsesi këtu duhet përmendur në veçanti edhe sfidat me të cilat HANDIKOS ballafaqohet, duke u bazuar 100 % në projekte, pa asnjë mbështetje të përhershme sidomos kur kemi të bëjmë me shërbimet të cilat ende nuk ofrohen nga institucionet vendore.

Personat me aftësi të kufizuara duhet të jenë pjesë e integruar e shoqërisë në tërësi dhe atyre duhet t'ju ofrohet mundësia drejt pavarësimit individual, ku përmes përvojës, talenteve dhe kapaciteteve të tyre të kontribuojnë në zhvillimin e shtetit tonë.

Afrim Maliqi

Drejtor

Përmbledhje Ekzekutive

Raporti Vjetor – 2019 paraqet një pasqyrë përmbledhëse të të arriturave të HANDIKOS përgjatë vitit 2019 në kuadër të programeve të implementuara. Të dhënat e raportuara janë të bazuara në të arriturat e HANDIKOS-it në implementimin e projekteve të mbështetura nga donatorë vendorë dhe atyre të huaj. Përmes shërbimeve të ofruara përgjatë një viti për fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuara si dhe prindër/familjarë të tyre, HANDIKOS ka vazhduar misionin e tij për të avancuar situatën e aftësisë së kufizuar në vend. Për më tepër, përgjatë një viti, puna e palodhshme e HANDIKOS ka ndikuar dukshëm në mirëqenien sociale të personave me aftësi të kufizuara në Kosovë përmes ndikimit në politika, udhëzime administrative, ligje dhe rregullore të tjera.

Përgjatë një viti, HANDIKOS ka ofruar shërbime direkte për 76 fëmijë me aftësi të kufizuara dhe 97 të rritur me aftësi të kufizuara në regjionin e Prishtinës. Njëkohësisht janë ofruar shërbime të pajisjeve ndihmëse për 303 persona me aftësi të kufizuara në Kosovë. HANDIKOS gjatë vitit 2019, ashtu sikurse në vitet e kaluara, përmes këshillave ligjore ka ndikuar në përmbushje të të drejtave njerëzore për personat me aftësi të kufizuara. Përgjatë një (1) viti, 215 të tilla janë ofruar për personat me aftësi të kufizuara në mbarë Kosovën, të cilat kryesisht ishin relevante me mbështetjen e tyre në parashtrimin e kërkesave/ankesave të cilat iu referoheshin vlerësimeve/përfitimeve ligjore apo të ngjashme.

Bashkëpunimi i ngushtë që HANDIKOS ka vazhduar ta mbajë me organizatat e shoqërisë civile, organizatat e personave me aftësi të kufizuara, organizatat ndërkombëtare, institucionet lokale dhe qendrore, shoqërinë, dhe vetë komunitetin e aftësisë së kufizuar, ka ndikuar dukshëm në funksionimin e përditshëm, adresimin e nevojave të personave me aftësi të kufizuara si dhe avancimin e situatës së tyre në shoqëri. HANDIKOS vazhdon të punojë për një shoqëri gjithëpërfshirëse, me njohje dhe realizim të plotë të të drejtave njerëzore për personat me aftësi të kufizuara.

HYRJE

- HISTORIKU I HANDIKOS

HANDIKOS (Shoqata e Paraplegjikëve dhe e Paralizës së Fëmijëve të Kosovës) është themeluar më 1983, me iniciativën e z. Halit Ferizi, kryetar i atëhershëm i shoqatës dhe më vonë lider i lëvizjes së aftësisë së kufizuar në Kosovë, së bashku me një grup të qytetarëve me aftësi të kufizuara. Objektivi kryesor ishte “përmirësimi i të drejtave dhe i standardeve të jetesës së personave me aftësi të kufizuara në Kosovë”, përmes veprimit në fushën e mbrojtjes shëndetësore, sociale dhe të punësimit.

Prej themelimit e deri në ditët e sotme, HANDIKOS është përkrahur nga një numër i konsiderueshëm i organizatave ndërkombëtare dhe vendore të cilat i kanë mundësuar HANDIKOS ekzistencën për më shumë se dy (2) dekada. Në fillimet e saj, HANDIKOS mbështetje të madhe ka pranuar nga: “Handicap International”, “OXFAM”, Agjencia Finlandeze FIDIDA, Qeveria e Finlandës, Ambasada e Finlandës, Organizata Italiane “Onlus Wamba-Athena”, “Onlus Roberto Bazzoni”, “Save The Children”, “UNICEF”, Agjencia Evropiane për ndërtime dhe rindërtim, mbështetës të cilët kanë mundësuar misionin dhe vizionin e HANDIKOS.

Pavarësisht mungesës së statistikave vendore për numrin dhe prevalencën e aftësisë së kufizuar në vend, në databazën e saj, HANDIKOS numëron më shumë se 18,000 anëtarë me aftësi të kufizuara fizike dhe të kombinuara të moshave, gjinive dhe etnive të ndryshme në mbarë Kosovën. HANDIKOS ka ofruar shërbime sociale në komunitet dhe shtëpi për fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuara, si dhe familjarët e tyre. Për më tepër, përgjatë gjithë kësaj përvoje, HANDIKOS është orientuar gjithashtu edhe në avokim dhe lobim për njohje dhe respektim të të drejtave të njeriut për personat me aftësi të kufizuara në Kosovë duke intervenuar në vetëdijen e shoqërisë si dhe në akte ligjore dhe nënligjore.

HANDIKOS ndër vite ka modeluar dhe ofruar sete të ndryshme të programeve rehabilituese të cilat kanë mbështetur gjithë personat me aftësi të kufizuara në vend dhe familjet e tyre. Të gjitha këto, HANDIKOS i ka ofruar përmes programit të Rehabilitimit të Bazuar në Bashkësi - RBB, program ky të cilin HANDIKOS e ofron që nga viti 2002 në Prishtinë, Podujevë, Gjiilan, Ferizaj, Gjakovë, Prizren, Suharekë, Malishevë, Vushtrri, Pejë, Istog, Mitrovicë; në kuadër të të cilave, sete të shumta të shërbimeve dhe teknikave avokuse janë implementuar. Së fundmi HANDIKOS në kuadër të programit të RBB-së është duke modeluar qasjen bio-psiko-sociale në të gjitha shërbimet e saj, qasje kjo e cila sheh personin në qendër nga këndvështrime të ndryshme.

Me gjithë veprimet që janë ndërmarrë viteve të fundit, personat me aftësi të kufizuara në Kosovë vazhdojnë të përballen me sfida të ndryshme në të gjitha aspektet jetësore të cilat u pamundësojnë atyre realizimin e të drejtave njerëzore dhe një jetese të dinjitetshme siç është reflektuar edhe në Kushtetutën e Kosovës dhe në aktet e tjera ligjore të vendit.

Bazuar në hulumtimet e fundit nga Organizata Botërore e Shëndetësisë, konsiderohet se rreth 15% e popullsisë së botës kanë të paktën një aftësi të kufizuar. Në Kosovë, sipas regjistrimit të fundit të popullsisë figurojnë rreth 93.288 persona me aftësi të kufizuar, përderisa statistikën nga Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale, gjatë vitit 2016 raportojnë për vetëm 26.247 persona me aftësi të kufizuara të cilët përfitojnë nga skemat e ndryshme sociale dhe shërbimet me destinim.

- HANDIKOS (aktualisht)

HANDIKOS në strategjinë e saj zhvillimore pesë (5) vjeçare (2018-2022) ka ristrukturuar veprimtarinë e saj nëpërmjet qasjes programatike të reflektuar brenda në strategji, e cila nuk ka afektuar funksionimin e brendshëm të organizatës në implementimin e aktiviteteve të planifikuara për të adresuar çështjet relevante me aftësinë e kufizuar, megjithatë qasja programatike ka synuar stabilitetin dhe qëndrueshmërinë e organizatës dhe veprimeve të saj. Në kuadër të kësaj qasje, HANDIKOS qëllim të vetë strategjik ka paraparë të *Fuqizojë personat me aftësi të kufizuara për pjesëmarrje në shoqëri.*

- Vizioni ynë

“Shoqëri gjithëpërfshirëse, me njohje dhe realizim të plotë të të drejtave dhe mundësive të barabarta të personave me aftësi të kufizuara”.

- Misioni ynë

“Të arrijë ndryshime pozitive dhe të qëndrueshme në jetën e personave me aftësi të kufizuara, përmes përfaqësimit, mbrojtjes së të drejtave dhe përkrahjes së tyre”.

Në kuadër të Strategjisë Zhvillimore (2018-2022), HANDIKOS objektiva strategjike të saj ka paraparë:

1. *Pjesëmarrja* – të rrisë pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara në jetën publike dhe politike;
2. *Punësimi* – të rrisë pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës;
3. *Edukimi dhe Trajnimi* – rritjen e pjesëmarrjes së personave me aftësi të kufizuara në edukimin gjithëpërfshirës dhe mësimin gjatë gjithë jetës;
4. *Mirëqenia Sociale* – të promovojë kushte të jetesës së dinjitetshme për personat me aftësi të kufizuara;
5. *Shëndeti* – të përmirësojë qasjen në shërbime shëndetësore cilësore; &
6. *Zhvillimi Organizativ* – ngritja e kapaciteteve të HANDIKOS-it dhe organizatave partnere.



PËR NJË SHOQËRI GJITHËPËRFSHIRËSE

Projektet që HANDIKOS ka implementuar gjatë 2019-ës

Promovimi i gjithëpërfshirjes në proceset konsultative për reformat e qeverisjes dhe administratës publike në sektorin e aftësisë së kufizuar në nivel lokal, nacional dhe regjional – Kosova Gjithëpërfshirëse (2019-2023), mbështetur nga Zyra e Bashkimit Evropian. Projekti zbatohet nga HANDIKOS, në partneritet me Disability Partnership Finland, Threshold, Shoqatën Kosovare të Shurdhërve dhe Shoqatën e të Verbërve të Kosovës me mbështetje nga Bashkimi Evropian.

Qëllim i përgjithshëm i projektit është një shoqëri gjithëpërfshirëse në të cilën personat me aftësi të kufizuara mund të realizojnë potencialin e tyre të plotë dhe të jetojnë një jetë të dinjitetshme si qytetarë të barabartë. Në kuadër të projektit janë paraparë këto objektiva:

- a) Reformat e qeverisë dhe administratës publike janë gjithëpërfshirëse për PAK;
- b) Fuqizimi i niveleve të ndryshme qeveritare për të draftuar, rishikuar dhe zbatuar një legjislacion gjithëpërfshirës për aftësinë e kufizuar;
- c) Fuqizimi i dialogut të OPAK me parlamentin dhe Qeverinë në nivel lokal dhe nacional; &
- d) Përmirësimi i avokimit të përbashkët të OPAK dhe rrjeteve të tyre.

- ***Promovimi i parandalimit të dhunës ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara në të gjitha mjediset në Kosovë (2017-2021) – mbështetur nga Save the Children dhe SIDA Suedeze.***

Qëllim i përgjithshëm i projektit është të promovojë dhe adresojë nevojat e fëmijëve me aftësi të kufizuara përmes përmirësimit të koordinimit ndër-sektorial dhe promovimit të masave të nevojshme për shtrirjen e aftësisë së kufizuar në të gjithë legjislacionin, politikat, sistemet dhe praktikat vendore. Projekti gjatë vitit 2019 ka synuar dy objektiva kyçe:

- a) Sistemet lokale, formale dhe jo formale, për mbrojtje të fëmijëve janë fuqizuar për të ofruar shërbime parandaluese, të qasshme, fleksibile dhe të ndjeshme ndaj gjinisë;
- b) Promovimi i llogaridhënies sociale të fokusuar tek fëmijët dhe masat e pjesëmarrjes së fëmijëve për të siguruar përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe sigurimin e shërbimeve të duhura specifike.

- ***Avancimi i situatës së fëmijëve me aftësi të kufizuara në Kosovë (2019-2020) mbështetur nga UNICEF.***

Qëllimi kyç i projektit është avancimi i situatës së fëmijëve me aftësi të kufizuara në Kosovë në fushën e mbrojtjes dhe pjesëmarrjes aktive përmes avancimit të legjislacionit aktual relevant me fëmijët me aftësi të kufizuara dhe qasjen në shërbime të kualitetit të lartë të bazuara në principe të modelit bio-psiko-social. Në kuadër të këtij projekti synohet të:

- a) Inkorporohet modeli i programit të RBB-së i bazuar në principe të qasjes bio-psiko-sociale në Ligjin Gjithëpërfshirës si dhe në draft plotësimet e ardhshme në legjislaturën vendore, relevante me fëmijët me aftësi të kufizuara;
- b) Të fuqizojë iniciativat e shkollave për të avancuar/siguruar qasje në shkollat e tyre për fëmijët me aftësi të kufizuara (të të gjitha kategorive);
- c) Të rritet dukshmëria e çështjeve që kanë të bëjnë me fëmijët me aftësi të kufizuara në Kosovë; dhe
- d) Të fuqizojë rrjetin e Qendrave të RBB-së në Kosovë në adresimin e çështjeve relevante me fëmijët me aftësi të kufizuara.

- ***Avancimi i të drejtave të njeriut, pjesëmarrja në shoqëri dhe kushtet për jetesë të pavarur për Personat me Aftësi të Kufizuara në Kosovë, Bosnje dhe Hercegovinë dhe në Ballkanin Perëndimor, mbështetur nga Threshold Finlandë.***

Qëllimi i përgjithshëm i projektit është avancimi i të drejtave të njeriut, pjesëmarrja në shoqëri dhe kushtet për jetesë të pavarur për Personat me Aftësi të Kufizuara në Kosovë.

Projekti synon:

- a) Të avancojë kapacitetet e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Organizatat e Personave me Aftësi të Kufizuara që të përmirësojnë standardet e jetesës.
- b) Të fuqizojë Personat me Aftësi të Kufizuara dhe Organizatat e Personave me Aftësi të Kufizuara që në mënyrë aktive të marrin pjesë në mekanizma bashkëpunues në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar me qëllim të integritetit të të drejtave të tyre në politikat e zhvillimit në të gjitha nivelet.
- c) Rritjen e ndërgjegjësimit të institucioneve dhe shoqërisë për të drejtat e PAK dhe promovimin e Avokimit të të drejtave të njeriut në mes të PAK në nivelin lokal dhe kombëtar.

- ***Ngritja e mirëqenies sociale të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe familjeve të tyre (2018-2019) mbështetur nga Save the Children në partneritet me zyrën e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe SIDA Suedeze.***

Qëllimi parësor në kuadër të projektit në fjalë është ofrimi i shërbimeve cilësore për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjarët të tyre përmes ofrimit të shërbimeve të kujdesit ditor. Në kuadër të projektit është synuar:

- a) Të krijohen dhe ofrohen shërbime cilësore të qëndrimit ditor me bazë në komunitet për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre në Regjionin e Prishtinës; dhe
 - b) Të rritet cilësia dhe zgjerimi i shërbimeve sociale cilësore të ofruara në komunitet për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre.
- ***Ofrimi i shërbimeve cilësore për fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuara në regjionin e Prishtinës (2019) – mbështetur nga Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale.***

Qëllim parësor i projektit është ofrimi i shërbimeve cilësore sociale me bazë në komunitet për fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuara si dhe mbështetja e familjarëve të tyre në ballafaqimin e aftësisë së kufizuar në situata të përditshme. Përmes këtij projekti është synuar të arrihet:

- a) Përmirësimi i mirëqenies sociale të fëmijëve dhe të rriturve me aftësi të kufizuara;
 - b) Përmirësimi i qasjes së drejtë dhe kujdesi i familjarëve ndaj familjarëve të tyre me aftësi të kufizuara.
- ***Ruajtja dhe përmirësimi i shëndetit të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe familjeve të tyre (Qershor – Nëntor 2019); mbështetur nga Ministria e Shëndetësisë.***

Në kuadër të këtij projekti është përmirësimi i shëndetit fizik dhe psikologjik për fëmijët me aftësi të kufizuara, përderisa është synuar të arrihet:

- a) Ofrimi i shërbimeve rehabilituese cilësore të qëndrimit ditor me bazë në komunitet për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre në Regjionin e Prishtinës;
- b) Rritja e cilësisë dhe zgjerimi i shërbimeve shëndetësore cilësore të ofruara në komunitet për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre.

- ***Përmirësimi i mirëqenies sociale të fëmijëve me aftësi të kufizuara në regjionin e Prishtinës (Nëntor 2019 – Shkurt 2020) – mbështetur nga Komuna e Prishtinës – Drejtoria për mirëqenie sociale.***

Qëllim kryesor në kuadër të projektit është të përmirësojë mirëqenien sociale të fëmijëve me aftësi të kufizuara në Regjionin e Prishtinës përderisa synohet të arrihet:

- a) Përmirësimi i zhvillimit fizik dhe psikologjik të fëmijëve;
- b) Avancimi i shkathtësive të pavarësimit për fëmijët me aftësi të kufizuara;

SHËRBIMET E OFRUARA PËRGJATË 2019-ës

➤ Shërbimet ditore për fëmijë


HANDIKOS në kuadër të Programit të RBB-së, në kuadër të projekteve që ka implementuar gjatë vitit 2019, ka arritur të ofrojë shërbime të kujdesit ditor në kuadër të qëndrimit ditor për më shumë se 70 fëmijë me aftësi të kufizuara në regjionin e Prishtinës. Shërbimet kyçe të ofruara përgjatë këtij viti kanë mbështetur zhvillimin holistik të fëmijëve me theks në shkathtësitë ditore, zhvillimin kognitiv, fizik dhe atë emocional.

Shërbimet e ofruara në kuadër të programit në fjalë janë zhvilluar duke vlerësuar nevojat e fëmijëve me aftësi të kufizuara nga ekipi multi disiplinor i HANDIKOS duke vënë fëmijën në fokus si dhe analizuar perspektivën e prindërve dhe ofruesve të tjerë të shërbimeve (kur është aplikuar). Bazuar në rezultatet e vlerësimit, plane individuale të intervenimit janë përpiluar për çdo fëmijë përfitues, përdërisa ri-shikimi i tyre është bërë në baza tre (3) mujore duke aplikuar procesin e ri-vlerësimit në të gjitha fushat e zhvillimit. Pavarësisht planifikimit individual për fëmijët përfitues, ekipi multi disiplinor në HANDIKOS në suaza të vazhdueshme ka zhvilluar punëtori 1-3 mujore në të cilat pjesëmarrja aktive e fëmijëve ka qenë e pa shmangshme. Përmes pjesëmarrjes në ato punëtori, fëmijët me aftësi të kufizuara kanë avancuar zhvillimin e tyre holistik përmes lojës dhe argëtimit. E gjithë kjo në baza mujore është raportuar për çdo fëmijë përfitues, ku më pas të njëjtat janë ndarë edhe me prindërit/kujdestarët duke i përditësuar ata me progresin mujor për fëmijët e tyre.


Të dhënat nga vlerësimi bazë i fëmijëve dhe ato nga ri-vlerësimi i fundit i realizuar në Dhjetor 2019 tregojnë rezultate të kënaqshme të punës me fëmijët me aftësi të kufizuara përgjatë një (1) viti.

Të dhëna demografike nga fëmijët përfitues					
76 fëmijë	Të ndara sipas gjinisë		Të ndara sipas moshës		
	Vajza	Djem	3-5 vjeç	5-6 vjeç	6-16 vjeç
	32	44	7	11	58

Në kuadër të programit në fjalë, përgjatë 2019-ës kanë funksionuar katër (4) dhoma të intervenimit të cilat në vete kanë qëllime specifike në mbështetje të zhvillimit të fëmijëve, gjegjësisht fusha e zhvillimit të komunikimit ekspresiv dhe atij receptiv, fushën e zhvillimit të shkathtësive ditore, atë të socializimit dhe të shkathtësive motorike fine dhe grose, janë fusha në të cilat fëmijët me aftësi të kufizuara kanë pranuar mbështetje. Përgjatë një viti intervenues, nga 47.4 sa ishte mesatarja e zhvillimit të fëmijëve me të cilët është punuar (në fushat e vlerësuara) ajo është ngritur në 51.7 tek 76 fëmijë përfitues.



Impakt më i dukshëm është identifikuar në zhvillimin e komunikimit ekspresiv, shkathtësive ditore personale dhe zhvillimin e aftësive motorike grose.



Në mënyrë të përbushjes së objektivave të synuara me fëmijët me aftësi të kufizuara (për mbështetjen e zhvillimit të tyre), një kamp i rehabilitimit aktiv është organizuar gjatë vitit 2019. Gjatë kësaj ngjarje, 15 fëmijë me aftësi të kufizuara përfituan nga rehabilitimi fizikal i organizuar me qëllim të avancimit të shëndetit të tyre fizik, përderisa përmes implementimit të aktiviteteve rekreative gjatë kampit, të njëjtët janë mbështetur edhe në zhvillimin njohës dhe atë emocional.


➤ Shërbimet ditore për të rritur

Paralelisht shërbimeve të ofruara për fëmijët me aftësi të kufizuara, HANDIKOS ka punuar intenzivisht edhe me 97 të rritur me aftësi të kufizuara (51B & 46FG, përmes shërbimeve të ofruara në Qendër dhe ato në shtëpi. Përgjatë një viti HANDIKOS ka ofruar shërbime sociale për 30 persona me aftësi të kufizuara (12G & 18B) në kuadër të programit të RBB-së, shërbime këto të cilat kanë mbështetur personat me aftësi të kufizuara në njohjen dhe funksionalizimin e afiniteteve të tyre, zhvillimin e shkathtësive ditore të cilat kanë mbështetur jetesën e pavarur, si dhe njohjen e të drejtave njerëzore për personat me aftësi të kufizuara dhe mbrojtjen e tyre.

Të dhëna demografike nga të rriturit përfitues				
97 të rritur	Të ndara sipas gjinisë		Të ndara sipas shërbimeve	
	Gra	Burra	Qendër	Shtëpi
	46	51	30	67

Përgjatë një viti, HANDIKOS ka ofruar nëntë (9) takime me përfituesit e saj me qëllim të avancimit të njohurive të tyre në aspektin shëndetësor dhe fizik, duke i mbështetur ata në ruajtjen dhe përparimin e shëndetit (përfshirë këtu manovrimin me pajisje ndihmëse, teknika të përdorimit të pajisjes ndihmëse, referime për marrjen e shërbimeve relevante shëndetësore dhe njohuritë thelbësore në menaxhimin e krizave shëndetësore, të cilat vijnë si rezultat i aftësisë së kufizuar). Për më tepër, HANDIKOS përgjatë 2019-ës, në bashkëpunim edhe me anëtarët e saj, ka realizuar 12 aktivitete rekreative jashtë Qendrës të cilat përveç impaktit pozitiv tek vetë anëtarët kishin impakt të gjerë edhe në shoqëri duke e bërë kështu çështjen e aftësisë së kufizuar më vizibile.


Për çdo anëtar, HANDIKOS ka përpiluar plane individuale intervenuese në të cilën janë paraparë objektiva me qëllim të mbështetjes së tyre drejt jetesës së pavarur. Si rezultat, për 97 përfitues, përgjatë një (1) viti janë planifikuar 485 objektiva në të cilat është punuar përmes aktiviteteve/shërbimeve në kuadër të programit të RBB-së, përderisa nga ato janë arritur 413.



➤ Shërbimet e pajisjeve ndihmëse

HANDIKOS që nga themelimi i saj ka punuar me shumë bashkëpunëtor të huaj dhe vendor në plotësimin e nevojave për pajisje ndihmëse për personat me aftësi të kufizuara në Kosovë. Si Qendër e Resurseve, HANDIKOS edhe gjatë 2019-ës ka vazhduar të jetë distributor kyç për ndarjen e pajisjeve ndihmëse për personat me aftësi të kufizuara në Kosovë.

Gjatë vitit 2019, HANDIKOS ka ofruar shërbime të pajisjeve ndihmëse për 303 persona me aftësi të kufizuara (170G & 133B) në mbarë Kosovën, gjegjësisht ka shpërndarë 303 pajisje ndihmëse. Kryesisht janë shpërndarë karroca (të tipit standarde, aktive, për të gjitha terrenet dhe karroca të tualetit), gjithashtu janë shpërndarë edhe shëtitore, paterica dhe shtretër ortopedik.



Për më tepër, HANDIKOS gjatë vitit 2019 ka shpërndarë edhe 11 karroca standarde dhe 11 paterica për qytetarët nga Shqipëria me rastin e tërmetit.

Për të gjithë përfituesit e pajisjeve ndihmëse, HANDIKOS fillimisht ka vlerësuar gjendjen e personit, duke vlerësuar kështu shëndetin e tij fizik dhe nevojën për pajisje ndihmëse, më pas të njëjtit iu janë administruar edhe matjet e nevojshme për ofrimin e pajisjes ndihmëse së përshtatshme. Pajisja ndihmëse e destinuar për personin është montuar dhe përshtatur në hapësira të HANDIKOS ku më pas përdoruesi i tyre është trajnuar për përdorimin, manovrimin dhe mirëmbajtjen e saj, e gjithashtu edhe kujdestari i tij/saj.

Karrocat që HANDIKOS ka shpërndarë gjatë vitit 2019 janë karroca donacion të pranuar nga Fondacioni *Ditët e Vona të Jezus Krishtit, Kuvendi Komunal në komunën e Prishtinës* dhe donator privat.

➤ Shërbimet juridike

Këshilltari Ligjor i HANDIKOS ofron shërbime juridike dhe gjyqësore për personat me aftësi të kufizuara. Gjatë vitit 2019, janë dhënë gjithsej:

Këshilla Juridike	Padi	Ankesa
215	40	20

Këshillat Juridike u janë dhënë personave me aftësi të kufizuara në mënyrë të drejtpërdrejtë, qoftë përmes vizitave në zyre qoftë përmes mjeteve tjera të komunikimit.

Paditë janë bërë në Gjykatën Administrative, dhe kryesisht janë ngritur për pretendimet për konstatimet e gabuara të Komisionit Vlerësues për Vlerësimin e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik¹. Dy (2) nga paditë janë ngritur për familjarët e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Rezulton se deri në momentin e raportimit, dy (2) raste janë vendosur nga gjykata, në dobi të paditësve.

Ankesat u janë drejtuar Këshillit të Ankesave në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale lidhur me pretendimet për vlerësimin e gabuar lidhur me pensionet për personat paraplegjik dhe tetraplegjik.

¹ Ligji për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik, <https://qzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12554>

Këshilltari Ligjor i HANDIKOS, në emër të organizatës ka paraqitur një kërkesë në Këshillin Gjyqësor të Kosovës, lidhur me pagesën e taksës gjyqësore, dhe si rezultat KGJK-ja ka ndryshuar Udhëzimin Administrativ për Taksën Gjyqësore, me të cilin ndryshim personat me aftësi të kufizuara janë liruar nga pagesa e taksës gjyqësore në të gjitha rastet kur ata/ato i drejtohen gjykatave. Gjithashtu, këshilltari ligjor ka mbajtur edhe disa takime me zyrtarë publik me qëllim të avokimit për qasjen fizike dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

➤ Shërbime të tjera

HANDIKOS në kuadër të programit të RBB-së ka ofruar edhe shërbime të tjera të cilat kanë ndikuar në avancimin e situatës së fëmijëve dhe të rriturve me aftësi të kufizuara në vend. Si rrjedhojë përgjatë një (1) viti HANDIKOS ka ndikuar në uljen e paragjytimeve ndaj aftësisë së kufizuar, mobilizim të komunitetit dhe avancimin e mbështetjes nga prindërit/kujdestarët dhe ofruesit e shërbimeve.

Si rrjedhojë, përgjatë vitit 2019 HANDIKOS ka realizuar 56 sesione informuese në shkollat e ciklit të edukimit të mesëm të ulët në komunën e Prishtinës, Gjakovës, Ferizajt dhe Mitrovicës. Përgjatë këtyre sesioneve 1444 fëmijë janë vetëdijesuar për aftësinë e kufizuar me theks të veçantë tek fëmijët me aftësi të kufizuar dhe rëndësinë e përfshirjes së tyre. Për më tepër, gjatë vitit 2019, HANDIKOS ka realizuar edhe sesione informuese për 608 ofrues të shërbimeve në teknikat e komunikimit dhe tipologjinë e aftësisë së kufizuar e gjithashtu edhe në promovimin e parandalimit të dhunës ndaj fëmijëve me theks të veçantë tek fëmijët me aftësi të kufizuara.

Në kuadër të Fletënotimit Komunitar – instrument i llogaridhënies sociale, të cilin HANDIKOS e implementon që nga viti 2017, këtë vit HANDIKOS ka bashkëpunuar me Qendrat për Punë Sociale në komunën e Prishtinës, Gjakovës, Ferizajt dhe Mitrovicës. Kjo për adresimin e çështjeve relevante me shërbimet e këtij institucioni për fëmijët me aftësi të kufizuara.

HANDIKOS në vazhdimësi ka punuar edhe në ngritjen e kapaciteteve të anëtarëve të saj si dhe më gjerë. Gjatë vitit 2019 HANDIKOS në programin e Disiplinës Pozitive në Prindërim të Përditshëm ka trajnuar 146 prindër dhe ofrues të shërbime në të drejtat e fëmijëve dhe zhvillimin e tyre përgjatë tetë (8) sesioneve. Përlllogaritet që më shumë se 1,457 fëmijë janë përfitues indirekt nga ky shërbim (numri i fëmijëve që prindërit/ofruesit e shërbimeve kanë deklaruar).

HANDIKOS gjatë vitit 2019 ka punuar intenzivisht edhe në fushën e mbrojtjes së fëmijëve, e një nga format e aplikuar ka qenë edhe trajnimi i 88 fëmijëve me aftësi të kufizuara nga komuna e Prishtinës, Gjakovës, Ferizajt dhe Mitrovicës në format dhe parandalimin e dhunës. Për më tepër, programi trajnues është draftuar nga vetë fëmijët me aftësi të kufizuara përfaqësues të Grupit Avokues të fëmijëve me aftësi të kufizuara – HËNA.

INTERVENIME AVOKUESE DHE LOBUESE

Gjatë vitit 2019, HANDIKOS paralelisht me shërbimet e ofruara për komunitetin, ka punuar intenzivisht edhe në avancimin e situatës së fëmijëve dhe të rriturve me aftësi të kufizuara përmes avokimit dhe lobimit si në legjislacionin aktual po ashtu edhe në vetëdijen e komunitetit dhe shoqërisë në përgjithësi.

Si rrjedhojë, gjatë vitit 2019, HANDIKOS për herë të parë në Kosovë, ka shënuar 1 Mars-in ditën ndërkombëtare të përdoruesve të karrocës me moton *"Ne k'shtu lëvizim"*. Më shumë se 150 fëmijë dhe të rritur përdorues të karrocës, nga shtatë (7) regjionet e Kosovës, parakaluan në sheshin kryesor të Prishtinës duke përçuar mesazhe me qëllim të ngritjes së vetëdijes së shoqërisë për rëndësinë e pajisjeve ndihmëse (karrocës) dhe qasjes. Në të njëjtën ngjarje është organizuar një lojë e basketbollit në karrocë si dhe një vallëzim i përbashkët me parakaluesit.

HANDIKOS gjatë vitit 2019, me qëllim të avancimit të vetëdijes së shoqërisë për rëndësinë e përfshirjes sociale të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe mbrojtjen e tyre nga gjitha format e dhunës ka zhvilluar dhe shpërndarë edhe broshura informuese të cilat janë shpërndarë gjatë gjithë vitit në ngjarje të ndryshme të organizuara (N≈ 5,000). Për më tepër, me rastin e shënimit të 3 Dhjetor-it – Ditës Ndërkombëtare të personave me aftësi të kufizuara, këtë vit HANDIKOS ka lansuar edhe një video të animuar e cili ka treguar rëndësinë e përfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara në aktivitetet fizike në shkolla. Shënimin e 3 Dhjetorit – Ditës Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara, HANDIKOS këtë vit e ka shoqëruar edhe me publikimin e raportit me të gjeturat rreth legjislacionit vendor relevant me qasjen fizike për personat me aftësi të kufizuara.

Së fundmi, HANDIKOS në bashkëpunim edhe me 15 Qendra të RBB-së në Kosovë kanë draftuar një Strategji të përbashkët të Avokimit si dhe atë të Komunikimit për të avancuar situatën e fëmijëve me aftësi të kufizuara në Kosovë. Për më tepër, për 15 Qendrat janë ofruar edhe materiale didaktike me qëllim të lehtësimit të ofrimit të shërbimeve sociale për fëmijët me aftësi të kufizuara në komunat në të cilat Qendrat në fjalë operojnë.

Bashkëpunimi i ngushtë i Qendrave të HANDIKOS ka vazhduar edhe më tutje, ku vetëm gjatë vitit 2019 në bashkëpunim me Zyrën për Qeverisje të mirë, janë realizuar dhjetë (10) takime konsultative (Gjakovë, Prizren, Ferizaj, Prishtinë, Suharekë, Drenas, Gjiilan, Pejë, Vushtrri dhe Mitrovicë) me qëllim të diskutimeve rreth planit dhe strategjisë aktuale për personat me aftësi të kufizuara si dhe rekomandimeve për Planin e ardhshëm i cili do fillojë zbatimin nga viti 2021. Pjesë e takimeve ishin rreth 300 persona me aftësi të kufizuara (141G & 157B).

HANDIKOS ka vazhduar ngushtë bashkëpunimin me organizatat lokale dhe ato ndërkombëtare të personave me aftësi të kufizuara. Gjatë vitit 2019 është realizuar punësoria dy ditore për ngritje të kapaciteteve të këtyre organizatave, punëtori kjo e cila ka bashkuar 51 pjesëmarrës (16G & 35B).



Adresa: Rr. Nekibe Kelmendi, Veternik, pn. Prishtinë

Telefoni: +383 49 37 76 55

E-mail: handikos@handi-kos.org

HANDIKOS, 2020